

VENDIM
Nr. 821, datë 30.12.2017

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 929, DATË 17.11.2010, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN DHE PËRDORIMIN E FONDIT TË VEÇANTË”, TË
NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 23.4.2011, “Për kompetencat për përcaktimin e pagave dhe të shpërblimeve” dhe të nenit 11, të ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fund të pikës 9, të vendimit nr. 929, datë 17.11.2010, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Përgjashtimisht për vitin 2017, Komisionerëve të Pavarur të Kualifikimit, Komisionerëve Publikë dhe Gjyqtarëve të Kolegjit të Pavarur të Apelit, u jepet një shpërblim, në masën 100 000 (njëqind mijë) lekë.”.

2. Fondi prej 2 100 000 (dy milionë e njëqind mijë) lekësh përballohet nga fondi i veçantë i papërdorur nga ministritë dhe institucionet qendrore, për vitin 2017.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe institucionet e rivlerësimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama